

jurisict



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



BASHKIA SHKODËR

Nr. 11508 prot, datë më 17/8 / 2023

INSTAT

Nr. 267 prot, datë 18/8 / 2023

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

BASHKIA SHKODËR

DHE

INSTAT

Nënshkruhet kjo marrëveshje bashkëpunimi e cila hartohet në kuadër të programit të organizimit dhe realizimit të censit të popullsisë dhe të banesave në juridiksionin e bashkisë Shkodër, ndërmjet palëve:

Bashkia Shkodër, me Kryetar të Bashkisë z. Benet BECI, përfaqësuar në këtë marrëveshje me vendim delegimi nga Zv/Kryetari z. Onid Bejleri, mbajtës i dokumentit të identifikimit me nr. I10815124V, madhorë me zotësi të plotë për të vepruar, me adresë Rr. 13 dhjetori, Shkodër.

dhe

Instituti i Statistikave (INSTAT), me Drejtor të Përgjithshëm zj. Elsa DHULI, përfaqësuar në këtë marrëveshje me autorizim nga Përgjegjësjë e Zyrës Rajonale Shkodër, zj. Mimoza Volumi, mbajtëse e dokumentit të identifikimit me nr. G55821055S, madhorë me zotësi të plotë për të vepruar, me adresë Rr. Vllazën Huta, ndërtesa 35, Tiranë.

Për sa më sipër, palët bien dakord për si më poshtë vijon.

Neni 1

Baza ligjore

1.1 Ligji nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar; Ligji nr. 140/2020 “Për censin e popullsisë dhe të banesave”; Vendim i Kuvendit të Shqipërisë nr. 3/2023 për “Miratimin e planit

vjetor 2023 për zbatimin e programit të statistikave zyrtare 2022-2026. Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë me nr. 869 datë 28.07.2023 "Për ngritjen e grupit të punës për komisionin e censit në nivel bashkie".

Neni 2

Objekti dhe qëllimi

2.1 Objekt i kësaj marrëveshje është bashkëpunimi për organizimin dhe realizimin e procesit të censit të popullsisë dhe të banesave në juridiksionin e bashkisë Shkodër.

2.2 Qëllimi i marrëveshjes është ofrimi i të dhënave të besueshme statistikore për përmirësimin dhe njohjen sa më të mirë të realitetit demografik, ekonomik dhe shoqëror.

Neni 3

Afati i marrëveshjes

3.1 Afati i kësaj marrëveshje bashkëpunimi është nga momenti i nënshkrimit të saj deri më datë 25 dhjetor 2023.

Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet e palëve

4.1 Bashkia Shkodër në kuadër të këtij bashkëpunimi institucional siguron dhe vë në dispozicion ambientet për ushtrimin e funksionit të këtij procesi.

4.2 Mbështet INSTA-in për zgjidhjen e problematikave të mundshme gjatë procesit të censit.

4.3 Asiston INSTAT-in gjatë planifikimit dhe zbatimit të menaxhimit të punës në terren.

4.4 Ndhmon INSTA-in gjatë procesit të rekrutimit të punonjësve në terren.

4.5 Raportojnë INSTA-it për ecurinë e përbushjes së detyrave.

4.6 INSTAT njofton bashkinë Shkodër për hapat që duhen marrë për censin.

4.7 INSTAT udhëzon komisionin e ngritur për detyrat që kanë për mbështetjen e censit.

4.8 INSTAT-i mund të ndërmarrë çdo aktivitet tjetër të domosdoshëm për kryerjen e censit, sipas nevojave.

Neni 5

Ligji i zbatueshëm dhe zgjidhja e konflikteve

5.1 Kjo akt marrëveshje rregullohet në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

5.2 Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis palëve në lidhje me këtë akt marrëveshje do të zgjidhet me mirëkuptim.

5.3 Marrëveshja mund të ndryshohet vetëm nëpërmjet një dokumenti me shkrim të nënshkruar nga të dyja palët.

Neni 6
Dispozita Përfundimtare

6.1 Palët janë të detyruara të respektojnë këtë marrëveshje për të gjithë kohëzgjatjen e saj.

6.2 Secila palë garanton se ka autoritet dhe kompetenca të plota për të nënshkruar dhe zbatuar marrëveshjen e bashkëpunimit dhe të kryejë të gjitha përfaqësimet e vendosura.

Neni 7
Gjuha dhe numri i kontratave

Kjo marrëveshje bashkëpunimi hartohet në gjuhën shqipe, në 3 (tre) kopje të barasvlefshme, të nënshkruara me vullnet të plotë nga të dy palët.

Për Bashkinë Shkodër
Kryetari
Z. Benet BECI
Me vendim delegimi
Zv/Kryetar
Onid BEJLERI



Për INSTAT
Drejtor i Përgjithshëm
Zj. Elsa DHULI
Me autorizim
Përgjegjëse e Zyrës Rajonale
Mimoza VOLUMI

